



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË  
22.11.2023**

Me datë 22.11.2023, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Hilmi Lakti, Jona Leqejza, Uarda Gjekaj, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkoçaj, Armela Brahimi, Mirsad Bashi, Hedije Nasa, Ardit Taflaj, Alma Mehmetaj, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Irena Shala, Izmira Rusi, Artan Haxhi, Elmira Ndrevasaj, Irma Kopliku, Elis Doci, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Eliona Shkreli, Aleksander Pashuku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahimi, Violeta Perndrecaj, Gjovalin Ndoj, Samed Bushati, Gloria Shllaku, Muharrem Shkjau, Amina Lici.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit Z.Oltion Luli  
Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Tetor 2023".*
2. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e listës shtesë të përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti"*
3. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave për periudhën 2023-2032"*
4. Pr/ Vendim: *"Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri"*
5. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e dhurimit të impiantit fotovoltai i cili do të vendoset pranë shkollës "Kol Idromeno" dhe dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet subjektit "Euroelektra" shpk dhe përfituesit Bashkia Shkodër"*
6. Pr/ Vendim: *"Për disa ndryshime në VKB nr.10 datë:20.07.2023 "Për miratimin e strukturës, numrit, anëtarëve të komisionit të përhershëm të Këshillit bashkiak Shkodër"*
7. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Fjalën e merr **Z.Bjanku**, i cili shprehet mbi Pr/vendimin e mbledhjes së kaluar, lidhur me dhënien pa kundëshpërblim të ish konviktit S.Spahiu ndërrmarrjes së Ujësjetllësit sh.a. dhe kërkon që të përfshihet në rendin e ditës edhe diskutimi mbi pretendimin e familjes Shiroka për të drejtën e parablerjes.

**Z.Luli** shprehet se këtë diskutim mund ta bëjmë në fund të mbledhjes, në diskutime jashtë rendit të ditës.

Hidhet në votim rendi i ditës, ku rezultojnë 37 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

Kalohet në pikën e parë të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Tetor 2023"*.

Relaton **Z.Malocaj**, drejtor në drejtorinë e ndihmës ekonomike në Bashkinë e Shkodrës sipas materialit të përgatitur nga administrata. Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 38 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

Vijohet me pikën 2. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e listës shtesë të përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti"*

Relaton **Znj.Kruja**, drejtore në drejtorinë e Shërbimeve sociale në Bashkinë e Shkodrës sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Nga ana e Komisionit të çështjeve ligjore fjalën e merr **Znj.Gjekaj** e cila shprehet se në mbledhjen e komisionit është rënë dakort që të vihet në dispozicion i gjithë dokumentacioni së bashku me listën e të skualifikuarve dhe arsyeja e skualifikimit. Megjithatë komisioni është pro miratimit të këtij Pr/vendimi.

Edhe **Z.Sokoli** kërkon të dijë nëse personat e skualifikuar për mungesë dokumentacioni mund të aplikojnë përsëri.

Përgjigjet **Znj.Kruja** që personat e skualifikuar mund të aplikojnë përsëri kur të hapet procedura.

**Znj.Glorja Shllaku** shprehet se konstaton që në listën e të skualifikuarve nuk është asnjë person i komunitetit Rom-egjiptian, duke qënë se janë komunitet që kanë përparësi në ligjin për strehim.

**Znj.Kruja** shprehet se komisioni I posaçëm për strehim kryen përzgjedhjen në bazë kriteresh dhe më sistem pikësh të miratuara, dhe në këtë rast nuk janë plotësuar këto kriterë.

**Znj.Gjekaj** kërkon të dijë nëse pjesë e komisionit të strehimit është edhe administrator social, i cili vlerëson rastet. Ky është edhe një sugjerim nga ana e saj.

**Znj.Kruja** shprehet se pjesë e komisionit është drejtori i drejtorisë së Ndihmës ekonomike por jo administratorët social, megjithatë vlerësojmë sugjerimin dhe do e kemi patjetër në konsideratë në vazhdim.

Edhe **Z.Bjanku** kërkon të dijë se personat e kualifikuar a janë vërtet fitues edhe nga institucionet financiare.

Përsëri përgjigjet **Znj.Kruja** e cila thotë se ekziston mundësia që personat e kualifikuar të mos kualifikohen fitues nga bankat por kjo nuk është përgjegjësi e jona.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 41 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

### **Miratohet**

Vijohet me pikën 3.të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave për periudhën 2023-2032”*

Relaton **Znj.Shllaku**, drejtore në drejtorinë e Mjedisit në Bashkinë e Shkodrës sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Nga ana e Komisionit të çështjeve ligjore fjalën e merr **Znj.Gjekaj** e cila shprehet se ky komision nuk ka kompetencë shqyrtimin e këtij Pr/vendimi.

Fjalën e merr **Znj.Golemi** e cila thotë se në relacionin e paraqitur në njërin nga tabelat shkruhet se këto ngastra do kenë prerje përfundimtare, pse nuk ka ndonjë propozim që këto ngastra të kenë pyllëzim.

**Znj.Shllaku** sqaron se termi prerje përfundimtare nuk ka të bëjë me prerjen e pyllit por janë procese teknike dhe prerje drusore.

**Z.Pashuku** propozon që të pranishëm në mbledhjet e komisionit të jenë edhe administratorët e njësive administrative, pasi janë më koherent me çështjen.

**Z.Shkjau** shprehet se meqënëse bëhet fjalë për pyjet , duhet të ketë vëmendje edhe për kurorën e qytetit si p.sh: Kodrat e Tepes, Ajasëm etj.

Përgjigjet **Znj.Shllaku** e cila vlerëson propozimin por thekson që Kodrat e Tepes deri para 6 muajsh kanë qënë zonë e mbrojtur dhe nuk administroheshin nga Bashkia Shkodër edhe pse janë pjesë e territorit tonë. Vetëm tani i kaluar në administrim Bashkisë dhe patjetër që do kenë vëmendjen e duhur.

**Znj.Shala** kërkon të dijë nëse është menduar se si do inspektohen këto ndërhyrje dhe a ka bashkia kapacitete për të kontrolluar territorin .Po ashtu a është marr parasysh e drejta e përdorimit mbi bazën e traditës për këto kullota dhe si do veprohet në këto raste?

Përsëri **Znj.Shllaku** shprehet se e drejta e përdorimit nga komuniteti nuk njihet me ligj. Shfrytëzimi bëhet vetëm me anë të një kërkesë apo projekti. Në lidhje me pyetjen e parë , nuk do të thotë se plani do menaxhohet krejtësisht nga Bashkia. Plani është 10 vjeçar dhe me anë

të projekteve dhe me një procedurë të caktuar ligjore do arrihet inspektimi, kontrolli dhe çdo gjë përsa i përket planit në fjalë.

**Z.Sokoli** kërkon të dijë nëse janë të rregjistruara këto kullota/prona pranë zyrës së regjistrimit.

**Znj.Shllaku** shprehet se pronat janë në process regjistrimi në kuadër të një projekti mjedisor të Ministrisë së Mjedisit dhe Bankës botërore. Bashkia Shkodër aktualisht ka kryer të gjithë inventarizimin e pyjeve dhe është në procedurë regjistrimi.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 40 vota Pro, 0 Kundër, 1 Abstenim.

#### **Miratohet**

Vijohet me pikën 4.të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”*

Relaton **Z.Luleta**, drejtor në drejtorinë e Shërbimeve Publike në Bashkinë e Shkodrës sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 41 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Kalohet në pikën 5. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për miratimin e dhurimit të impiantit fotovoltaik i cili do të vendoset pranë shkollës “Kol Idromeno” dhe dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet subjektit “Euroelektra” shpk dhe përfituesit Bashkia Shkodër”*

Përsëri relaton **Znj.Shllaku**, drejtoreshë në drejtorinë e Mjedisit në Bashkinë e Shkodrës sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Nga ana e Komisionit të çështjeve ligjore fjalën e merr **Znj.Gjekaj** e cila shprehet se në mbledhjen e komisionit është lënë si detyrë që në marrëveshje të shtohet edhe qëllimi i dhurimit. Po ashtu edhe një vërtetim hipotekor i rifreskuar të shkollës “K.Idromeno”. Këto janë lënë si kusht, për plotësim përpara lidhjes së marrëveshjes përfundimtare. Megjithatë komisioni është pro miratimit të këtij Pr/vendimi.

**Znj. Nika** kërkon të dijë pse është pikërisht shkolla K.Idromeno përfitues i këtij impianti?

Përsëri **Znj.Shllaku** thotë se investitori ka qënë i interesuar që kjo shkollë të jetë përfituese edhe për arsye teknike. Thëkson gjithashtu që kompania nuk ka asnjë përfitim përveç promovimit.

Edhe **Zv/ kryetari** përgjigjet se duke qënë se bëhet fjalë për dhurim nuk jemi ne që mund të vendosim kushtet. Ka qënë krejtësisht zgjedhje e investitorit, po ashtu është kryer edhe studimi për kushtet teknike.

**Z.Sokoli** merr fjalën dhe vlerëson dhurimin në fjalë dhe shpreson që edhe në vazhdim të kemi të tilla donacione.

**Z.Anamali** kërkon të dijë a do ndikojë vendosja e këtij impianti në rikostruksionin që do kryhet në këtë shkollë?

**Znj.Shllaku** shprehet se në marrëveshjen që do lidhet me subjektin në fjalë, patjetër që do rregullohet edhe kjo pjesë.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 41 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Kalohet në pikën 6. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *"Për disa ndryshime në VKB nr.10 datë:20.07.2023 "Për miratimin e strukturës, numrit, anëtarëve të komisionit të përhershëm të Këshillit bashkiak Shkodër"*

Relaton mbi këtë pr/vendim kryetari i Këshillit **Z.Luli** sipas materialit të përgatitur.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 40 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Kalohet me diskutime jashtë rendit të ditës.

**Z.Bjanku** merr fjalën dhe flet mbi pr/vendim e mbledhjes së kaluar, për kalimin pa kundërshtim i ish-konviktit S.Spahiu tek ndërmarrja e UKSH-së. Ai shton se bëhet fjalë për një pretendim të familjes Shiroka për të drejtën e parablerjes në rastet kur shteti nuk e përdor pronën. Kjo është e drejtë ligjore që i takon familjes në fjalë. Kërkoj që ky pretendim të merret në konsideratë dhe të diskutohet ana procedurale e tij.

**Z.Luli** sqaron se si procedurë ligjore në cilësinë e anëtarit të Komisionit për çështjet ligjore ju mund ta diskutoni dhe të lini rekomandimet tuaja lidhur me çështjen në fjalë. Ai shton se nga ana prefektit ka ardhur shkresa lidhur me qëndrimin kundrejt pretendimit të familjes Shiroka. Patjetër që Këshilli do diskutojë dhe do mbajë qëndrim lidhur me çështjen në fjalë.

**Znj.Gjekaj** edhe njëherë sqaron rëndësinë e diskutimit të këtij pretendimi, duke thënë se duhet të jemi sa më transparent me opinionin publik duke ditur edhe se sa e rëndësishme është prona private dhe e drejta që i lind familjes Shiroka.

**Znj.Shala** kërkon të dijë, nëse nuk është kryer tjetërsim i pronës si mund t'i kalohet kjo godinë UKSH-së?

**Z.Luli** sqaron përsëri se me VKB funksioni/përdorimi i godinës ka ndryshuar, nuk është më ai arsimor por përdorim qendre shëndetësore dhe administrim.

**Z.Sokoli** shprehet se zyra juridike në Bashki mund të sqarojë më së miri mbarë opinionin publik në lidhje me këtë diskutim.

Fjalën e merr **Znj.Leqejza**, drejtore e drejtorisë juridike në Bashkinë Shkodër e cila sqaron edhe njëherë arsyet e këtij pr/vendimi dhe mos qënurit në kushtet e shqyrtimit të kërkesës për të drejtën e parablerjes së familjes Shiroka. Nëse ky pretendim do vinte në rastin kur Bashkia nuk ka interes për pronën atëherë ajo do i nështrohej një procedure tjetër, e cila kryhet nga Ministria e Financës.

**Znj.Nika** ngre një shqetësim dhe kërkesë të banorëve të Nj.adm Gur i zi në lidhje me hapjen e një kopshti fëmijësh në ambientet e shkollës Z.Jubani. Kërkesë kjo që vjen për tu marr në shqyrtim ose parashikuar në buxhetin e ardhshëm, duke patur parasysh që është kërkesë e mbështetur në ligj dhe shkolla i ka ambientet për hapjen e kopshtit.

**Z.Bejleri** përgjigjet se patjetër që kërkesa do merret parasysh dhe do jetë prioritet në përfshirje në buxhet.

**Znj.Mehmetaj** në cilësinë e kryetares së Komisionit të buxhetit relation sipas materialit të përgatitur në lidhje me problematikën e largimit të të rinjëve. Duke kërkuar edhe mbështetjen e Bashkisë për to.

**Z.Anamali** shprehet se ai ka depozituar prane sekretarisë së bashkisë një kërkesë për informacion lidhur me cilët janë indikatorët, metodologjia, çfarë të dhënash janë mbledhur për taksën e pastrimit, për kategori të ndryshme të përcaktuara në paketën fiskale, pasi akoma nuk kam marr një përgjigje. Ai gjithashtu shton edhe një tjetër shqetësim nga banorët e rrugës E.Osmani, pranë prokurorisë, ku me vendosjen e korsive të biçikletave I është mohuar e drejta e parkimit të mjeteve. Po ashtu edhe në rrugën Mbreti Gent. Ai kërkon rishikimin e kësaj problematike.

Përgjigjet **Zv/kryetari**, i cili shprehet se grupi i punës ka konkluduar në të gjitha të dhënat dhe arsyet për tarifim dhe beson se shumë shpejt do merrni një përgjigje.

**Znj.Pode** po ashtu ngre një tjetër shqetësim të banorëve që banojnë në kryqëzimin e rrugës Qafë-Kala deri tek depot e ujit. Bëhet fjalë për një ndërhyrje në një segment rrugor rreth 600-700 m që ka nevojë për ndërhyrje. Me këtë segment lidhet edhe Lgj. Tepe dhe prandaj është shumë i rëndësishëm. Tjetër shqetësim qytetar janë edhe tregjet e rrobave të përdorura, të cilët kërkojnë përmirësim të kushteve të tregtimit.

**Znj.Shkrela** shpreh shqetësimin qytetar lidhur me derdhjen e ujrave të zeza nga ndërrmarrja e ujës-jellësit në lumin Kir. Shpreson që të merren masa që kjo çështje e shëmtuar të mos përsëritet. Së dyti ajo shton se Kryetari i bashkisë në rrejtet sociale është shprehur në lidhje me një treg që do hapet në Lgj.Qafë-Hardhi, ajo kërkon të dijë nëse ky treg është public apo privat, për më tepër a është marr leje për prishjen e një banese të vjetër aty? Gjithashtu ajo shton se nëse kjo pronë është publike dhe po ndërtohet ku do merren fondet për këtë treg dhe a mund të bëhet transparent projekti i tij?

Përgjigjet **Z.Bejleri** duke thënë se kemi një vendim prishjeje, gjithmonë me dakortësinë e pronarëve për të krijuar një hapësirë publike, në mënyrë që tregtarët që tregtojnë tek sheshi Isa Boletini të mund të sistemohen tek kjo hapësirë e organizuar dhe me standarte. Më pas do vijmë edhe me formën e bashkëpunimit me pronarët e objektit, që gjithsesi në gjendjen që ka qënë, ishte e rrezikshme dhe jashtë çdo standarti. Patjetër që çdo gjë do bëhet transparente në momentin që do kemi edhe një projekt të tregut.

**Znj.Shkrela** shpreh tjetër problematikë lidhur me disa premtime për ndërhyrje në disa rrugë të qytetit, ajo kërkon të dijë arsyet e mosfillimit të punimeve? Si p.sh Terminali i autobuzëve, hyrja e Shkodrës dhe rruga Shirokë- Zogaj.

Përgjigjet përsëri **Z.Bejleri** duke thënë se kemi të bëjmë me dy projekte të ndryshme për hyrjen e qytetit, njëri është harku i Bërdicës deri tek ura e Bahcallekut dhe tjetri është hyrja e Shkodrës. Janë investime të financuara një pjesë nga FSHZH-ja dhe një pjesë nga qeveria shqiptare. Bashkia nuk është aktori i vetëm tek këto projekte.

Edhe në lidhje me rrugën Shirokë-Zogaj kemi hasur disa probleme me shpronësimet por jemi drejt zgjidhjes dhe shumë shpejt do fillojnë punimet. Kurse për terminalin e autobuzëve jemi në fazën e vlerësimit dhe do vazhdojmë edhe aty shumë shpejt.

**Z.Doçi** shprehet në lidhje me korsitë e biçikletave në zonën e Pedonales duke thënë se nuk e sheh të nevojshme një korsi të tillë pasi është shëtitore dhe mendon se duhet rishikuar.

**Z.Bejleri** përgjigjet duke thënë se korsitë janë vendosur në zona të caktuara në bazë të një studimi të mirëmenduar.

**Z.Behri** merr fjalën dhe kërkon të dijë se meqënëse jemi në prag festash, a ka Bashkia ndonjë plan promovimi për qytetin?

**Z.Bejleri** thotë se po punohet fort që ky vit të jetë shumë i veçantë , duke filluar me zbukurimet, koncertet, aktivitetet dhe promovimet për të tërhequr sa më shumë vizitorë.

**Z.Osmanagaj** shprehet se vëren se nuk janë marr seriozisht kërkesat dhe shqetësimet e qytetarëve sepse ashtu si kolegu Behri ai mendon se jemi shumë vonë , kur na ndajnë betën 15 ditë nga festat.

**Z.Bashi** thotë se si pjesë e kësaj fushe promotore ai di që Bashkia ka filluar me kohë punën dhe angazhimet në promovimin e qytetit për festat e fundvitit.

**Znj.Shllaku** shprehet se në mbledhjet e kaluara është ngritur si problematikë përdorimi i sallave/palestrave të shkollave nga komuniteti. Ajo kërkon të dijë nëse janë tashmë të aksesueshme këto ambiente?

Përgjigjet përsëri **Z.Bejleri** duke thënë se puna për rregullimin e tyre vazhdon dhe ne jemi po ashtu të idesë që këto ambiente sportive të jenë të hapura pasditeve për banorët e zonës.

**Znj.Golemi** shpreh tjetër shqetësim lidhur me hapësirat e plazheve publike, duke qënë se janë hapur aplikimet për sezonin që vjen. Ajo thotë se plazhet publike zënë një pjesë shumë të vogël.

**Z.Bejleri** thotë se Bashkia Shkodër ka dërguar propozimin e saj lidhur me hartën e shfrytëzimit të hapësirave private dhe atyre publike dhe këtë vit do ketë shtim të hapësirës publike për shfytësim, deri në 30%. Do bëhet gjithashtu menaxhim më i mirë i tyre duke mos mbetur thjesht në letër.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.

Kryetari i Këshillit **Z.Luli** deklaron të mbyllur mbledhjen.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 22.11.2023. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 3 faqe

Zbardi procesverbalin

Irma Sulishti

Sekretar

Denis LESH



KRYETAR

Oltion LULI

